



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 212 dt.20.10.1994

PER
KALIMIN E PALLATIT TE KULTURES "STUDENTI" TE
UNIVERSITETIT BUJQESOR NGA VARTESIA E BASHKISE
SE TIRANES NE ATE TE UNIVERSITETIT BUJQESOR

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.20.10.1994, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Seksioni i Kulturës “Për kalimin e pallatit të kulturës “Studenti” të UB nga vartësia e Bashkisë së Tiranës në atë të Universitetit Bujqësor”, duke u mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.153, dt.03.04.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve përkatëse”,

VENDOSI

1. Pallati i Kulturës “Studenti” deri tani në vartësi të Bashkisë së Tiranës, të kalojë nën administrimin e Universitetit Bujqësor.
2. Qendra Ekonomike e Kulturës të bëjë dorëzimin e Inventarit të saj.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Seksioni i Kulturës dhe Qendra Ekonomike e Kulturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA